



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.03.2025  
Numër protokoli: 1822/2025

A.nr. 265/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurë sipas ankesës A.nr.265/2025, të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesja S.B, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.265/2025 të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesja S.B

**II.** Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

## A r s y e t i m

S.B. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 03.02.2025 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë me numër protokoli 727/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.265/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa përmes parashtrësës së datës 03.02.2025 ka bërë plotësimin e ankesës si në petitutimin e saj, kundër shkresës së datës 19.10.2022 të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Berlin/Gjermani, kundër kontratës së marrëdhënies së punës me nr. Ref: ARKS 02/2022 të datës 25.10.2022 si dhe kundër shkresës së datës 21.05.2024 ( pa nr.protokoli)

të Ambasadorit të Republikës së Kosovës përmes të cilës ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se institucioni punëdhënës me rastin e shfuqizimit të kontratës Ref:MPJ-ZDP/A-002 dhe 01/2018 të datës 01.08.2018, ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm si dhe në kundërshtim me Shtojcën- Personeli Administrativ dhe Teknik Personeli Shërbyes dhe Personeli i Punësuar vendor, neni 33 si dhe Kreun VI të kësaj Shtojce ndërlidhur me nenin 33 dhe 27, si dhe me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës përmes shkresës së datës 21.05.2024, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, nenin 44 paragrafi 1, nenin 47 dhe nenin 48.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) nga shqyrtimi dhe analizimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja fillimisht është punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe se e njëjta sipas Kontratës së Punës të datës 12.10.2009, ishte emëruar në pozitën e punës “Asistente Administrative” në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin/Gjermani, në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, pastaj përmes Kontratës së Punës të datës 19.07.2012 e njëjta kishte vazhduar të mbajë pozitën e njëjtë “Asistente Administrative”, sipas Kontratës së Punës të datës 01.01.2015 e njëjta kishte vazhduar të mbajë pozitën e njëjtë “Asistente Administrative”, dhe po ashtu përmes kontratës së datës 01.11.2016 ankuesja kishte vazhduar të mbajë pozitën e njëjtë “Asistente Administrative” në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin/Gjermani.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, Ambasadori i Republikës së Kosovës në Berlin-Gjermani përmes shkresës së datës 23.07.2018 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD, me kërkesën që për shkak të riorganizimit të personelit të brendshëm të ambasadës, ankuesen të emëroj në pozitën “Asistente Ekzekutive”, dhe për rrjedhojë të njëjtës me datë 01.08.2018 i është lëshuar Kontrata e Punës me shifër: MPJ-ZDP/A-002 ku ankuesja sistemohet në pozitën “Asistente Ekzekutive”, mirëpo me datë 19.10.2022 Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, i drejtohet Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Berlin, se avancimi i ankueses nga pozita e “Asistentes Administrative” në pozitën “Asistente Ekzekutive” sipas kontratës së datës 23.07.2018, shfuqizohet sepse është emëruar pa kaluar procedurat e rekrutimit, ndërsa Ambasadori i Republikës së Kosovës në Berlin-Gjermani i drejtohet ankueses përmes shkresës së datës 19.10.2022 duke e njoftuar ankuesen mbi shfuqizimin e kontratës së datës 23.07.2018 sipas sqarimeve të dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, kurse ankueses i lëshohet Kontratë e re e Punës, me datë 25.10.2022 përmes së cilës ankuesja emërohet në pozitën Asistente Administrative”, kurse me datë 21.05.2024 Ambasadori

Republikës së Kosovës në Berlin-Gjermani, e njofton ankuesen se marrëdhënia e saj e punës do të përfundoj me datë afektive nga 24.07.2024.

Kolegji i Këshillit fillimisht me qëllim të konstatimit të kompetencës lëndore, analizoj dispozitat e legjislacionit për shërbimin e jashtëm, gjegjësisht nenin 2 lidhur me përkufizimet dhe termat e përdorur, nenin 36 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “2. *“Personeli administrativ dhe teknik”- janë anëtarët e personelit të misionit të punësuar në shërbimin administrativ dhe teknik të misionit; 36 Misionet diplomatike mund të punësojnë shtetas të shtetit pranues, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për kryerjen e punëve administrative, teknike dhe shërbyese.*”, ndërlidhur me nenin 3 të udhëzimit Administrativ Nr.05/2012 për Pagat e Personelit Vendor në Misionet Diplomatike a Konsullore të Republikës së Kosovës

Po ashtu, Kolegji i Këshilli mori për bazë edhe dispozitat e aplikuara të ligjit për zyrtarët publik i cili ka qenë në fuqi deri me datë 25.09.2023, gjegjësisht nenin 2 paragrafi 2, 3 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “2. *Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës; 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë; 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.*

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, Kolegji i Këshillit në mbështetje dhe duke bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 5 ku është përcaktuar se: “Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. **Nëpunësja/i i shërbimit civil;** 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. **Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës;** dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit..; 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/e/s statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/e/s i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 5. **Nëpunësja/i teknik dhe**

***mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike***”, konstaton se pozita e ankueses nuk është pozitë e nëpunësit civil, rrjedhimisht nisur nga vet titulli i pozitës të punës rrjedhë se pozita e ankueses hynë në kategorinë e nëpunësve teknik dhe mbështetës, çështje kjo e përcaktuar edhe në vetë kontratat e punës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 27 paragrafi 1, nenit 95 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, rithekson faktin së nëpunësi teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohet te punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimit se ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.265/2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë te brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:**Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda, A.nr.265/2025, datë 19/03/2025.**

**Flakron GASHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokat Hajzer Salihu;
- Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.